

VENDIM
Nr. 246, datë 12.4.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
ZHVILLUESIT TË NJË TERRITORI TË ZONËS EKONOMIKE SPITALLË, DURRËS, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT PËR SHOQËRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, dhe të neneve 4 pika 1 shkronja “g”, 5 pikat 1 e 3, dhe 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien e statusit të zhvilluesit të parkut industrial, në një territor prej 67.5 (gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesë) ha, në zonën ekonomike Spitallë, Durrës, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 7 pikësh për studimin ekonomik-financiar, studimin e fizibilitetit teknik dhe studimin e ndikimit në mjedis, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, që i jepet shoqërisë “Ylberi” sh.p.k., Tiranë.
 3. Sipërfaqja për ndërtimin e parkut industrial të jepet me çmimin 1 (një) euro.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha